



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 210/1 Prot.

Tiranë, më 7 / 2 / 2019

V E N D I M

Nr. 24 , Datë 07 / 02 / 2019

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën Nr. 134, datë 07.09.2018, të bërë nga një grup personash¹, banorë të prekur nga zbatimi i projektit: “Unaza e Madhe e Tiranës, segmenti, Komuna e Parisit - Rruga e Kavajës” kundër Këshillit të Ministrave në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “racës”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna, në ankesë, subjektet deklarojnë se kanë qenë të përfshirë në kategorinë e familjeve që janë trajtuar me qira 3 vjeçare në bazë të VKM-s nr. 230, datë 13.03.2015 i Këshillit të Ministrave “Për trajtimin me pagesë të qirave për disa familje që preken nga zbatimi i projektit: Unaza e madhe e Tiranës, segmenti, Komuna e Parisit - Rruga e Kavajës”, të ndryshuar. Afati i trajtimit me pagesë qiraje sipas vendimit të mësipërm, ka përfunduar në muajin Mars 2018. Në përfundim të afatit i janë drejtuar Bashkisë Tiranë me qëllim sigurimin e vazhdimësisë së strehimit në ambientet me qira dhe kanë marrë premtimin se do të mbështeten duke u trajtuar në vijim përmes programit social të bonusit të strehimit. Kërkesa për t’u trajtuar sipas programit social të strehimit u kushtëzua me dorëzimin e një sërë dokumentesh, sipas kërkesave të nenit 24 të ligjit nr.9232, datë 13.05.2004 “Për programet sociale të strehimit”, të ndryshuar dhe akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të këtij ligji. Gjatë muajit Shkurt dhe Mars 2018, rreth 33 familje, u përpoqën për të mbledhur dokumentacionin e kërkuar, nga ku u ndeshën me një sërë vështirësish dhe problematikash të ndryshme për sigurimin e dokumentacionit të

¹Subjektet: E.S, D.S, B.M, L.M, Z.M, A.M, P.G, A.D dhe Z.D i përkasin komunitetit Rom të Shqipërisë, të cilët janë prekur nga projekti për ndërtimin e Unazës së Madhe të Tiranës.

kërkuar. Në mbledhjen e datës 07.06.2018, Këshilli Bashkiak Tiranë ka vendosur trajtimin me bonus strehimi vetëm për 15 familje të komunitetit rom dhe egjiptian të Selitës. Ndërkohë, 18 familje të tjera aplikuese nuk arritën të përfitonin nga ky program, për shkak të mungesave në dokumentacion. Subjektet ankuese shpjegojnë se, nga konsultimi me vendimet e marra nga Këshilli i Ministrave janë njohur se për familjet të cilat janë prekur nga zbatimi i projektit “Lidhja e rrugës transballkanike me superstradën Fier-Vlorë” do vijojë trajtimi me pagesë qiraje, në bazë të VKM nr.254, datë 09.05.2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr.58, datë 21.01.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për trajtimin e disa familjeve që preken nga zbatimi i projektit “Lidhja e rrugës transballkanike me superstradën Fier-Vlorë” me programe sociale të strehimit”” të ndryshuar.

Ankuesit shpjegojnë se situata e tyre është e njëjtë me atë të familjeve të Vlorës, pasi me prishjen e banesave, banorët e të dy qyteteve u trajtuan me pagesë qiraje 3-vjeçare nga buxheti i shtetit, por siç u shpjegua më sipër, ndonëse janë në situatë të njëjtë, trajtimi i banorëve të Tiranës nuk vijon të jetë i barabartë me banorët e Vlorës për shkak të racës.

Subjektet ankuese, kërkojnë nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit, dhe marjen e masave për zgjatjen e afatit të trajtimit me pagesë qiraje, sipas VKM nr. 230, datë 13.03.2015, për familjet e komunitetit rom dhe egjiptian të zonës së Selitës, Tiranë.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Neni 7 i LMD-së², në pikën 1 të tij, parashikon se: “Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”.

Bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

² Shkurtesë për Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

Me shkresën nr.1295, datë 19.09.2018, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi i ka rekomanduar Këshillit të Ministrave, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkisë Tiranë, si më poshtë:

1. “Marrjen e masave nga ana e institucioneve përgjegjëse sipas fushave të tyre të kompetencave dhe përgjegjësisë, për sigurimin e strehimit të qëndrueshëm dhe afatgjatë të familjeve të komunitetit rom dhe egjiptian, të cilat kanë mbetur të pastreha si rezultat i zbatimit të projektit “Unaza e madhe e Tiranës, segmenti Komuna e Parisit–Rruga e Kavajës”.
2. Marrjen e masave nga ana e institucioneve përgjegjëse sipas fushave të tyre të kompetencave dhe përgjegjësisë, për të siguruar vazhdimin e trajtimit me pagesë qiraje deri në sistemimin me strehim në një nga programet që parashikon ligji për strehimin, të familjeve të cilat janë trajtuar në bazë të VKM nr. 230, datë 13.05.2015 “Për trajtimin me pagesë të qirave për disa familje që preken nga zbatimi i projektit: Unaza e Madhe e Tiranës, segmenti Komuna e Parisit-Rruga e Kavajës”, të ndryshuar.
3. Marrjen e masave nga ana e institucioneve përgjegjëse sipas fushave të tyre të kompetencave dhe përgjegjësisë, për kordinimin dhe lehtësimin e procesit, si dhe mbledhjen e dokumentacionit të kërkuar për të aplikuar në programet që parashikon ligji për strehimin, për familjet të cilat janë trajtuar sipas VKM nr. 230, datë 13.05.2015, të ndryshuar, deri në sistemimin e tyre në një nga programet e strehimit të parashikuar nga ligji.

Në përgjigje të rekomandimit të mësipërm, Ministria e Financave dhe Ekonomisë me shkresat nr.16901/2, datë 24.10.2018 dhe nr.16901/3, datë 14.11.2018, ka informuar Komisionerin se: “Ministria e Financave dhe Ekonomisë, si ministria përgjegjëse për politikën e strehimit, ka përgatitur projekt-vendimin “Për disa shtesa e ndryshime në VKM Nr.230, datë 13.03.2015 “Për trajtimin me pagesë të qirasë të disa familjeve që preken nga zbatimi i projektit “Unaza e madhe e Tiranës, segmenti Komuna e Parisit-Rruga e Kavajës” i ndryshuar. Projekt vendimi parashikon trajtim me bonus qiraje të familjeve të ndikuara nga zbatimi i projektit për ndërtimin e Unazës së madhe të Tiranës deri në zgjidhjen me një formë të qëndrueshme strehimi. Projekt-vendimi do të nisët për mendime në Ministrinë e Drejtësisë dhe më pas për miratim në Këshillin e Ministrave”.

- Me shkresën nr. 1214/1, datë 28.09.2018, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar dhe kërkuar informacion nga Këshilli i Ministrave për ankesën e bërë nga një grup personash, banorë të prekur nga zbatimi i projektit: “Unaza e Madhe e Tiranës, segmenti, Komuna e Parisit - Rruga e Kavajës” kundër Këshillit të Ministrave në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “racës”. Nga ana e Këshillit të Ministrave nuk ka pasur një përgjigje mbi kërkesën e bërë.
- Me shkresën nr.1214/3, datë 05.11.2018 Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka njoftuar përsëri Këshillin e Ministrave për kërkesën për informacion.

Me shkresën nr.4247/3, datë 05.11.2018 të administruar pranë Komisionerit me nr.1554, datë 06.11.2018 Këshilli i Ministrave ka vënë në dijeni Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, se Këshilli i Ministrave ka ngarkuar për ndjekje dhe kompetencë Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për ndjekjen e rekomandimit të Komisionerit lidhur me çështjen e strehimit të komunitetit rom dhe egjiptian, në zonën e Selitës, Tiranë.

- Mbështetur në nenin 33/8, të ligjit nr. 10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës nr.134, datë 07.09.2018, Komisioneri me shkresën nr. 1214/4, datë 13.11.2018 njoftoi palët për zhvillimin e seancës dëgjimore më datë 22.11.2018 duke kërkuar shpjegime nga Këshilli i Ministrave për çështjen në fjalë.

Në seancën dëgjimore të zhvilluar në datën 22.11.2018, morën pjesë disa nga subjektet ankues: E.S, B.M, L.M, Z.M, A.M, P.G dhe disa përfaqësues të shoqërisë civile të cilët kanë qenë në mbështetje të banorëve të prekur nga zbatimi i projektit të unazës, ndërsa Këshilli i Ministrave dërgoi parashtrimet e tij me shkresë.

Gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore, ankuesit konfirmuan dhe njëherë vështirësitë për sigurimin e strehimit të familjeve të tyre si dhe problematikat e hasura për të përfituar nga programet sociale të strehimit të ofruara nga Bashkia Tiranë. Të pranishmit informuan Komisionerin se në mbledhjen e Këshillit Bashkiak të Tiranës të datës 15.11.2018 ishte vendosur miratimi i bonusit të strehimit për katër familje³ që janë subjekt i ankesës.

Në përgjigje të shkresës së Komisionerit nr. 1214/4, datë 13.11.2018, Këshilli i Ministrave me shkresën nr.4480/3, datë 22.11.2018 në mes të tjerash ka informuar se: *“Këshilli i Ministrave ka vullnet të plotë për krijimin e mundësive për strehim të përshtatshëm e të përballueshëm për të gjitha familjet që kanë nevojë për strehim, si dhe për ndihmën e shtetit, sipas legjislacionit në fuqi. Pretendimi për diskriminim të banorëve për shkak të racës, me argumentin se familjeve të prekura nga zbatimi i projektit “Lidhja e rrugës transballkanike me superstradën Fier-Vlorë” (në vijim, familjet e Vlorës) u është mundësuar vijimi i trajtimit me pagesë qiraje, në bazë të Vendimit nr.254, datë 09.05.2018 të Këshillit të Ministrave, është i pabazuar. Procedura për hartimin e projektvendimit për rastin e familjeve të Vlorës ka filluar pasi Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka konstatuar se këto familje nuk mund të përfitonin bonus strehimi nga Bashkia Vlorë, fakt ky që i vendos në kushte objektivisht të ndryshme nga familjet e Selitës. Afati 3-vjeçar i trajtimit me pagesë qiraje për familjet e Vlorës përfundoi në muajin Janar të vitit 2018. Ndërkohë, afati 3-vjeçar i trajtimit me pagesë qiraje për familjet e Selitës, në përputhje me vendimin nr.230, datë 13.03.2015, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, përfundoi në muajin mars 2018. Gjatë kësaj kohe, këto familje ishin në proces trajtimi të dokumentacionit të tyre të aplikimit për bonus strehimi nga Bashkia Tiranë. Ministria e Financave dhe Ekonomisë është njohur me kërkesën e familjeve të Selitës, pasi një pjesë e tyre ka marrë përgjigje negative nga Bashkia Tiranë, për pamundësinë e përfitimit të bonusit të strehimit, për shkak të mangësive në dokumentacionin e kërkuar. Menjëherë pas njohjes së problematikës në bashkëpunim me Bashkinë e Tiranës, për mënyrën e adresimit të zgjidhjes së problemit e të ndarjes së*

³ Familjet: Z.D, A.D, K.M dhe A.S.

përgjegjësi në menaxhimin e programit të bonusit të qirasë, u përgatit projektvendimi “Për disa shtesa e ndryshime në VKM Nr.230, datë 13.03.2015 “Për trajtimin me pagesë të qirasë të disa familjeve që preken nga zbatimi i projektit “Unaza e madhe e Tiranës, segmenti Komuna e Parisit-Rruga e Kavajës” me qëllim përfitim nga programi social i strehimit të pagesës së qirasë, deri në sistemimin me strehim në një nga programet që parashikon ligji për strehimin. Në përputhje me ligjin nr.9000, datë 30.01.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave” dhe me Vendimin nr. 584, datë 28.08.2003, “Për miratimin e rregullores së Këshillit të Ministrave” të ndryshuar, projektvendimi u dërgua për mendim pranë Ministrisë së Drejtësisë, e cila, me shkresën nr. 10329/1, datë 23.10.2018, ktheu përgjigje negative, duke mos e miratuar propozimin me argumentin se, me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”, më datë 30.11.2018, vendimi nr.230, datë 13.03.2015, i ndryshuar, do të shfuqizohet. Ministria e Financave dhe Ekonomisë, me shkresën nr.20229, datë 12.11.2018, i ka kërkuar Ministrisë së Drejtësisë rivlerësimin e qëndrimit të saj. Nga verifikimet me Bashkinë Tiranë rezultoi se nga familjet e Selitës, të mbetura pa trajtim me bonus strehimi janë trajtuar edhe 8 raste të tjera. Sa më sipër, gjykojmë se nuk ka pasur asnjë veprim apo mosveprim të Këshillit të Ministrave, që mund të konsiderohet si diskriminues për rastin e familjeve të Selitës, krahasuar me rastin e Vlorës. Këshilli i Ministrave, për adresimin e zgjidhjes së problematikës, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, me hyrjen në fuqi të ligjit nr.22/2018, “Për strehimin social”, do të nisë menjëherë punën për hartimin e projektvendimit të ri për trajtimin me pagesë të qirasë të familjeve që preken nga zbatimi i projektit “Unaza e Madhe e Tiranës, segmenti Komuna e Parisit-Rruga e Kavajës” e që nuk trajtohen me bonus strehimi nga Bashkia Tiranë. Këshilli i Ministrave do të ndërmarrë gjithashtu të gjitha masat për miratimin sa më të shpejtë të projektvendimit të ri”.

Me shkresën nr. 109, datë 22.01.2019, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka kërkuar informacion nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë në lidhje me hapat e ndërmarrë për zgjidhjen sa më të shpejtë të ankesës së banorëve të prekur nga zbatimi i projektit: “Unaza e Madhe e Tiranës, segmenti, Komuna e Parisit - Rruga e Kavajës”.

Gjatë zhvillimit të procedurave hetimore, Komisioneri, mori dijeni se Këshilli i Ministrave me Vendimin nr. 44, datë 30.01.2019⁴ “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr. 230, datë 13.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për trajtimin me pagesë të qirasë të disa familjeve që preken nga zbatimi i projektit “Unaza e madhe e Tiranës, segmenti Komuna e Parisit-Rruga e Kavajës”” të ndryshuar, ka vendosur që subjektet e prekura nga zbatimi i projektit “Unaza e madhe e Tiranës, segmenti Komuna e Parisit-Rruga e Kavajës” të përfitojnë nga programi social i strehimit pagesën e plotë të qirasë, nga momenti i mbarimit të afatit të përcaktuar deri në sistemimin me strehim në një nga programet që parashikon ligji për strehimin.

Për sa më sipër, Komisioneri gjykon dhe vlerëson, se kërkesa e familjeve të prekura nga zbatimi i projektit: “Unaza e Madhe e Tiranës, segmenti, Komuna e Parisit - Rruga e Kavajës”, është plotësuar, pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi për të cilin është nisur ky hetim në drejtim të

⁴ Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 10, datë 5 shkurt 2019.

sigurimit të vazhdimet të trajtimit me pagesë qiraje të familjeve të sipërcituara deri në sistemimin me strehim në një nga programet që parashikon ligji për strehimin.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenet 3, 4, 7, pika 1, nenin 20, nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a), si dhe nenin 33, pikat 1, 3, 5, 7 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Pushimin e shqyrtimit të ankesës nr. 134, datë 07.09.2018, të bërë nga: E.S, D.S, B.M, L.M, Z.M, A.M, P.G, A.D dhe Z.D kundër Këshillit të Ministrave, pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi për të cilin është iniciuar procedura hetimore.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA